

Bachelor në **Art dhe Dizajn** (180 ECTC, 3 vite akademike, me kohë të plotë)

### **Profili kulturor dhe profesional**

Ky program studimi synon të japë njohuri bazë mbi artin dhe dizajnin si pjesë e një sërë veprimtarish formuese të artit të kombinuara me fusha të tjera aplikative të cilat sjellin një ngjyrim të ri në këtë formim.

Në këtë mënyrë, ky program studimi ka për qëllim të krijoj profilin e një eksperti të artit dhe dizajnit me formim më të gjerë, teorik e praktik, i cili të "kujdeset" jo vetëm për anën funksionale të objekte apo veprave të krijuara, por edhe atë estetike në fushën e dizajnit grafik, industrial, fashion, fotografisë, pikturë, skulpturë etj. Studentit i mundësohet më tej thellimi gjatë ciklit të dytë të studimeve në drejtime më specifike të artit, dizajnit përfshi edhe arkitekturën.

### **Temat kryesore që trajton ky program studimi:**

- *Formim i përgjithshëm*  
Historia e arkitekturës dhe qytetit; Historia e Artit; Arti Modern dhe Kultura Kontemporane;
- *Formim në kulturën artistike bazë dhe nga fusha të tjera*  
Baza të edukimit artistik; Gjuha Pamore; Piktura, Gjeometria Euklidiane; Vizatim i Lirë & Ilustrimi Grafik; Qeramika dhe Skulptura
- *Formim në gjini të veçanta të artit dhe të dizajnit*  
Fotografia; Artet Alternative dhe Konceptuale; CAD dhe Artet e Bazuara tek Kompjuteri; Dizajni Multimedial, Dizajni Grafik, projektim artistik, Skenografia, Muzeografia dhe Expo;

### **Mundësitë për punësim**

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

- Sektori privat i studiove artistike; artistë të pavarur përfshi edhe pjesën aplikative të artit; "industria" e marketimit, e botimeve, e mediave në përgjithësi, e veshjeve, e modës, e prodhimit të mobiljeve, etj
- Sektori publik: në nivelet e ndryshme të qeverisjes, për të trajtuar me një frymë të re çështjet që kanë të bëjnë me edukimin e shijes estetike dhe që kanë një shkallë të lartë të impaktit shoqëror.

### **Plani Mësimor si më poshtë vijon:**

Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive i programit të studimit

Bachelor në Art dhe Dizajn

Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredite total	Kredite (%)
A (formim baze i pergjithshem)	Baza te Edukimit Artistik (Filozofi Arti, Teori Imazhi)	6	36	20%
	Histori Arti I	6		
	Histori Arti II (Arti Modern & Kultura Kontemporane)	6		
	Histori Arkitekture dhe Qyteti I	6		
	Histori Arkitekture dhe Qyteti II	6		
	Dizajn Grafik I (Projektim Artistik)	6		
B (karakterizuese)	Vizatim dhe Ilustrimi Grafik I	6	84	47%
	Vizatim dhe Ilustrimi Grafik II	6		
	Gjeometria Euklidiane 1	6		
	Gjeometria Euklidiane 2	6		
	Piktura 1	6		
	Piktura 2	6		
	Qeramika dhe Skulptura	6		
	Teknika Artistike	6		
	Gjuha Pamore I	6		
	Gjuha Pamore II	6		
	Dizajn Grafik II	6		
	Dizajn Multimedial 1	6		
	Dizajn Multimedial 2	6		
	Teknologjia e Materialeve	6		
C (integruese)	Urban Art (Arti ne Komunitet)	6	18	10%
	Muzeografi & Expo	6		
	Fashion Design	6		
D (me perzgjedhje)	Lende me perzgjedhje 1	6	12	7%
	Lende me perzgjedhje 2	6		
E (formuese plotesuese)	CAD dhe Artet e Bazuara tek Kompjuteri 1	6	24	13%
	CAD dhe Artet e Bazuara tek Kompjuteri 2	6		
	CAD dhe Artet e Bazuara tek Kompjuteri 3	6		
	Metoda te kerkimit Shkencor	3		
	Internship Profesional	3		
F (Pergatitja tezes)	Teza dhe Projekt Diploma	6	6	3%
	<b>TOTAL</b>	<b>180</b>	<b>180</b>	<b>100%</b>